

11.477

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
No. 11477 Regj.

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 25.07.1995, une gjyqtarja e gjykates se
Tiranes Florence Tepu, pasi studiova
dokumentacionin e paragjitur nga kerkuesi Fejzi Astrit BOZGO,
lindur me 1950, i cili kerkon regjistrimin e shoqerise
"Shtypshkronja DEMOKRACIA" SH.F.K. si person juridik prane
kesaj gjykate.

K O N S T A T O V A

Se Zoti Fejzi Astrit BOZGO, me detyren e Drejtorit
Administrativ te Shoqerise "Shtypshkronja DEMOKRACIA" me
pergjegjesi te kufizuar ka kerkuar regjistrimin e kesaj
Shoqerie prane Gjykates se Rrethit Tirane. Shoqeria e ka
seline ne Tirane, rruga "Jordan Misja" dhe ka kete objekt te
veprimtarise se saj:

- a) Botimin e shitjen e gazetave, revistave dhe
shtypshkrimeve te cdo lloji qofshin.
- b) Importimin e linjave te reja si per mirembajtjen,
zgjerimin dhe rinovimin e shtypshkronjes Demokracia ashtu dhe
shitje per zhvillimin e medias elektronike me teknologji
bashkohore e te kompjuterizuar.
- c) Importimin e lendeve te para per shtypshkronjen dhe
pajisjeve e lendeve te tjera qe sherbejne si lende ndihmese
per botimet si dhe shitjen e tyre (letra, bojra dhe kimikate
te ndryshme, material filmik, si dhe kompjutera, makineri e
pajisje qe perdoren ne fushen e shtypit dhe te medias.)

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke.

Administrator i Shoqerise eshte Z.Fejzi Astrit BOZGO.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit 7638, date 12.11.1992 "Per Shoqerite
Tregtare"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses se Kerkuesit Fejzi BOZGO per
regjistrimin e Shoqerise "Shtypshkronja DEMOKRACIA" sh.p.k. si
person juridik. Shoqeria do ta kete seline ne Tirane, rruga
"Jordan Misja". Objekti i shoqerise do te jete:

- a) Botimi dhe shitja e gazetave, revistave dhe
shtypshkrimeve te cdo lloji qofshin.
- b) Importimi i linjave te reja si dhe mirembajtja,
zgjerimi dhe rinovimi i Shtypshkronjes DEMOKRACIA ashtu si dhe
shitje per zhvillimin e medias elektronike me teknologji
bashkekohore e te kompjuterizuar.

c) Importimi i lendeve te para per shtypshkronjen, pajisjeve e lendeve te tjera qe sherbejne si lende ndihmese per botimet e per shitjen e tyre (letra, bojra dhe kimikate te ndryshme, material filmik, kompjutera si dhe makineri e pajisje qe perdoren ne fushen e shtypit e te medias.)

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte prej leke 100.000.

Shoqeria do te veproje deri ne vitin 2005 mbi 10 vjet..

Administrator i shoqerise do te jete Z.Fejzi BOZGO.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Shkalles se Dyte.

G J Y Q T A R E

Flori meq Tegu
Fejz

Tirane, me 2. 07. 1995

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË

Nr. 11477/1 Vendimi

VENDIM
i Gjyqtarit të vetëm

Në Tiranë, sot më datën 30-12- 1999, unë gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Tiranë mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv i Shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k. Zotit **Arben Billaci**, për depozitimin e vendimit Nr. Ekstra të datës 29. 12. 1999 të Bordit Drejtues të Shoqërisë "Shtypshkronja Demokracia".

KONSTATOVA

Se me vendim nr. 11477 të datës 05. 07. 1995 të Gjykatës së rrethit Tiranë Shtypshkronja "Demokracia" Sh.p.k. është regjistruar si person juridik për të ushtruar veprimtari private të përcaktuar në këtë vendim. Me vendim nr ekstra dt 29. 12. 1999, Bordit Drejtues të Shoqërisë "Shtypshkronja Demokracia" është vendosur ndryshimi i administratorit të shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k. zotit Fejzi Bozgo dhe emërimin e administratorit të ri Zotit Arben Billaci.

Sa më sipër është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në statutin e Shoqërisë dhe si e tillë është e drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në bazë të ligjit 7638 dt. 19. 11. 1992 dhe ligjit 7667 dt. 28. 01. 1993

VENDOSA

Pranimin e kërkesës.

Depozitimin pranë regjistrit tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë të vendimit nr. ekstra dt. 29. 12. 1999 të Bordit Drejtues të Shoqërisë "Shtypshkronja Demokracia". në të cilin është vendosur ndryshimi i administratorit të shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k. zotit Fejzi Bozgo dhe emërimi i Zotit Arben Billaci.

Urdhërohet zyra e regjistrit tregtar të bëjë shënimet përkatëse në fletën e regjistrit në kolonën nr. 2, dhe nr. rendor 2.

GJYQTARE

Margjona Beqaj
Margjona Beqaj



Shoqeria "Shtypshkronja DEMOKRACIA"sh.p.k

Tirane - ALBANIA

Tel.oo355 42 28478

Fax.oo355 42 28446



AKT THEMELIMI

FONDACIONI Agjensia Shqiptare e Botimeve - Shtypshkronja Demokracia i drejtuar nga Bordi Drejtues perbere nga zoterinjte Arben Bllaci(Kryetari Bordit) Mehmet Elezi, Lorenc Ligori, Ylli Rakipi, Bardhyl Londo,ing Fejzi Bozgo(Drejtor Administrativ i shtypshkronjes) dhe Vangjush Saro,te gjithë shtetas shqiptare banues ne Tirane me zotesi te plota juridike per te vepruar me vullnetin te lire, mbeshtetur ne Statutin e FONDACIONIT Agjensia Shqiptare e Botimeve - Shtypshkronja DEMOKRACIA per funksionimin ligjor te tij si dhe ne Ligjet Neni 5 i Ligjit 7512 date 10.08.1991 dhe 7638 date 19/11/92 per Shoqerite Tregtare vendosi :

Krijimin e SHOQERISE " Shtypshkronja DEMOKRACIA Sh.p.k me keto kushte :

1. Shoqeria do te quhet -Shtypshkronja "Demokracia"sh.p.k.

2. Qendrën e vet do t'a ketë në Tiranë, Rr. "Jordan Misja"

3. Kapitali themelor i Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA eshte 100.000 (njqindmije)leke i derdhur prane Bankes Tregtare Shqiptare - Tirane.

4. Shoqeria "Shtypshkronja DEMOKRACIA" me te gjithë pronen e levizeshme e te palevizeshme eshte prone e Fondacionit " Agjensia Shqiptare e Botimeve" - Tirane

5. Aktiviteti i Shoqerise - Shtypshkronja DEMOKRACIA eshte :

- a) Botimi ,shtypja dhe shitja e gazetave, revistave dhe shtypshkrimeve të çdo lloji qe realizohen ne Shtypshkronjen DEMOKRACIA - prone e Fondacionit.

- b) Importimi linjave të reja si për mirëmbajtjen, zgjerimin dhe rinovimin Shtypshkronjës DEMOKRACIA ashtu dhe per zhvillimin e medias elektronike te redaksive e subjekteve shqiptare me teknologji bashkkohe.

- c) Importimi e shitje te materialeve dhe lendeve te para , paisjeve ndihmëse për botimet ne shtypshkronje si letra, bojra, lastra dhe kimikate të ndryshme, material filmik, kompjutera, si dhe paisje e makineri ne fushen e shtypjes e botimit si. etj,

6. QELLIMI : - te mbeshtesi financiarisht aktivitetin dhe qellimin e FONDACIONIT

Agjensia Shqiptare e Botimeve. si donator i vetem i ketij fondacioni..

STATUSI LIGJOR :

- 1) Shtypshkronja DEMOKRACIA zhvillon aktivitetin e saj ne perputhe me legjislacioni n shqiptar ne fuqi dhe ligjin baze "Per Shoqerite Tregtare - Nr.7638 i dates 19/11/1992.
- 2) Shtypshkronja DEMOKRACIA gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit.t ne rregjistrin Tregtar te Gjykates se Tiranes sipas Nenit 19 te Ligjit 7632 dt. 14.11.1992
- 3) Shoqeria Shtypshkronja DEMOKRACIA ka pasurine e saj qe ne çastin e krijimit qe arrin vleren mesatere prej 1 milion dollare amerikane te cilat do te perdoren per realizimin e objektivit te saj te percaktuar nga pronari i saj - FONDACIONI ASHB.
- 4) Organizimi dhe drejtimi i Shoqerise do te behet në përputhje me rregullat e Statutit, te Shoqerise që është pjesë përbërëse e këtij akti.

STATUTI ligjerohet me regjistrimin ne Gjykatën e Tiranes.

Ky Akt i hartuar në 4 kopje
Pasi u lexua, nënshkruhet para noteres nga themeluesit e Shoqerise Shtypshkronja
DEMOKRACIA

Arben BLLACI
(Kryetar i Bordit te Fondacionit ASHB)



Fejzi Bozgo
(Drejtori Administrativ i Shtypshkronjes DEMOKRACIA)



Tiranë 4.....Korrik 1995



REPUBLIKA E SHQIPERISE

N O T E R I A

No. 2344/Rep.
No. 875 Kol.

V E R T E T I M

Sot me date 4. Korrik 1995 (netedhjte e pese) para meje Noteres se Tiranes u paraqit Z. Fejzi Astrit BOZGO, madhor me zotesi te plota mendore e juridike per te vepruar ,per indentitetin e te cilit u sigurova nga dokumentat e tij personale, i cili deklaroi se kane hartuar kete AKT THEMELIMI te Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA Sh.P.K ne emer te Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve jashte kesaj zyre ,me vullnetin e tij te lire duke e nenshkruar ate rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas Ligjit.

NOTERE

Ruka Soko
.....

Tirane 4. Korrik 1995



STATUTI i Shoqërisë



Shtypshkronja DEMOKRACIA

KAPITULLI I

Neni 1

Shoqëria "Shtypshkronja Demokracia" është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në zbatim të Nenit 5 të ligjit 7512 si dhe ligjit no. 7638 datë 19/11/1992 "- Për shoqëritë Tregtare dhe pjesët tjetër të Legjislacionit Shqiptar që rregullon këto marrëdhënie.

Neni 2

Shoqëria " Shtypshkronja Demokracia" . është person juridik shqiptar dhe fillon aktivitetin mbas regjistrimit në Gjykatën e Tiranës

Themelues është FONDACIONI Agjencia Shqiptare e Botimeve - Shtypshkronja DEMOKRACIA

Neni 3

Selinë e saj Shoqëria Shtypshkronja DEMOKRACIA shp.k ka në Rrugën Jordan Misja.

Neni 4

Shoqëria Shtypshkronja Demokracia sh.p.k do të ushtrojë veprimtarinë e saj deri më 2005 mbi 10 vjet

Ky afat kohor mund të zgjatet me vendim Dordit Drejtues të Fondacionit. Agjencia Shqiptare Botimeve.

Neni 5

Shoqëria Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k ka për objekt veprimtarie :

- a) Botimin e shitjen e gazetave, revistave dhe shtypshkrimeve të çdo lloji qofshin.
- b) Importimin e linjave të reja si për mirëmbajtjen, zgjerimin dhe rinovimin e shtypshkronjës Demokracia ashtu dhe shitje për zhvillimin e medias elektronike me teknologji bashkohore e të kompiuterizuar.
- c) Importimin e lendeve të para për shtypshkronjes dhe pajisjeve e lendeve të tjera që shërbejnë si lëndë ndihmëse për botimet si shitjen e tyre (letra, bojra dhe kimikate të ndryshme, material filmik, si dhe kompjutera si dhe makineri e pajisje që përdoren në fushën e shtypit e të medias.)

Neni 6

Për realizimin e objektit të saj Shoqëria Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k. mund të përfundojë negociatën, marrëveshje dhe kontratë të ndryshme me çfarëdo lloj subjekti tjetër privat ose shtetëror, firmë e huaj ose shqiptare si dhe homologe të saj e të tjera.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe vendimeve të drejtorit ekzekutiv të saj Shoqëria Shtypshkronja DEMOKRACIA mund të kryejë të gjitha llojet e operacioneve financiare e tregëtare të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 7

Shoqëria - Shtypshkronja Demokracia shpk me kapitalin bazë shoqëror afro 1 milion dollarë USA (që ekziston sot duke vlerësuar ndertesen, makineri e pajisje, lendet e para e ndihmese si dhe token) është Prone ekskluzive e FONDACIONIT Agjensia Shqiptare e BOTIMEVE - Tirane.

Në asnjë rast fitimet nga përdorimi i kësaj pasurie nuk mund të kalojnë në favor të ndonjë individi ose si përfitime personale të personave të veçante (përfshirë rastet e pagave, shpërblimeve të punonjësve të Shoqërisë e punonjësve të Fondacionit si dhe shpenzimet e kryera për aktivitetin e Shoqërisë dhe Fondacionit ASHB.)

Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100000 leke i shlyer dhe i nënshkruar nga plotësisht nga ortaku i vetëm.

Neni 9

Shtypshkronja DEMOKRACIA e kryen aktivitetin dhe gjithë veprimtarinë e saj në mënyrë të pamvarur nga Shteti Shqiptar, nga Partitë Politike si dhe nga çdo lloj organizmi

tjeter brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

I vetmi organi cili administron dhe kontrollon aktivitetin e Shtypshkronjes DEMOKRACIA eshte Fondacioni AGJENSIA SHQIPTARE E BOTIMEVE dhe Bordi Drejtues i saj.

Neni 10

Administrator i vetem i Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA shpk eshte Ing Fejzi Bozgo,zgjedhur me vendimin e Bordit Drejtues te Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve

Drejtori administrativ i shoqerise varet direkt nga Bordi Drejtues i Fondacionit ASHB

Neni 13

Te gjitha veprimet financiare perkatese te aktivitetit te Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k.behen te regjistruara ne llogari financen e saj.

Ekspertet Kontabel te jashtem te marre nga Orgne Shteterore Financiare te Autorizuara duhet te siguroje kontrollin ,vertetesine dhe korrektesine e Bilancit Vjetor dhe veprimeve financiare te Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA shpk. si dhe te kontrolloje lidhjen e Bilancit Vjetor me llogarite e te ardhurave e shpenzimeve, qe rezultojne ne librat kontabel per tju paraqitur Bordit Drejtues te FONDACIONIT ASHB.

Neni 14

Ushtrimi i veprimtarise seshoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Drejtori Administrativ i Shoqerise merr masa per te perpiluar e paraqitur Bilancin e llogarine brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke thirrur mledhjen e Bordit Drejtues te Fondacionit.Agjensia Shqiptare e Botimeve. Me perpara relacioni dhe dokumentat justifikuese i vihen ne dispozicion Ekspertve Kontabel

Neni 15

Bordi Drejtues i Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve -Shtypshkronja DEMOKRACIA ka te drejte te beje dhe te aprovoje ndryshime ne STATUTIN e Shoqerise

Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k. ne ato raste kur e shikon kur statuti ekzistues nuk i pergjigjet ose kufizon veprimtarine e tij te metejshme.

Ky Statut u hartua në katër kopje në Tiranë sot më 4 Korrik 1995

Per Shoqerine " Shtypshkronja DEMOKRACIA"sh.p.k

Ing. Fejzi BOZGO (Drejtor Administrativ)





REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

No. 2345 Rep.
No. 276 Kol.

VERTETIM

Sot me date 4 Korrik 1995 (netedhete e pese) para meje Noteres se Tiranes u paraqit Z. Fejzi Astrit BOZGO, madhor me zotesi te plota mendore e juridike per te vepruar ,per indentitetin e te cilit u sigurova nga dokumentat e tij personale, i cili deklaroi se kane hartuar kete STATUT te SHOQERISE ''Shtypshkronja DEMOKRACIA Sh.P.K'' ne emer te Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve jashte kesaj zyre ,me vullnetin e tij te lire duke e nenshkruar ate rregullisht para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas Ligjit.

NOTERE

Ruko Soko

Tirane 4.Korrik 1995



KERKESE

Gjykatës së Rrethit - TIRANE



*regjistruhet
05.09.1991
Fejzi
1991*

KERKUESI : Fejzi Astrit Bozgo, i biri i Astrit Bozgos i lindur ne Tiranë me 27 Maj 1950 dhe banues ne Tiranë ,Rruga Vaso Pasha,Palati 26,SWhkalla 3/22 me Leter Njoftimi

OBJEKTI : Rregjistrimin si Person Juridik të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k ne baze te Nenit 5,te Ligjit 7512 date 10/08/1991 dhe të Ligjit 7638 datë 19/11/1992.

Unë i nënshkruari Fejzi Astrit BOZGO,ne baze te AKTIT TE THEMELIMIT per krijimin e Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA me themelues Fondacionin AGJENSIA SHQIPTARE E BOTIMEVE -shtypshkronja DEMOKRACIA kerkoj te ushroj aktivitetin privat me kete objekt veprimtarie :

OBJEKTI - Botimin shtypjen dhe shitjen e gazetave revistave dhe shtypshkrimeve te çdo lloji.
- Importimin e linjave per mirbajtje zgjerim dhe rinovimin e shtypshkronjes DEMOKRACIA si dhe shitje per zhvillimin medias elektronike te subjekteve te ndryshme qe punojne ne kete sferë.
- Importimin e e materialeve dhe lendeve te para e paisjeve qe duhen per prodhimin ne shtypshkronje si dhe per shitje si leter,bojra,lastra kimikate te ndryshme, materiale filmik , kompjutera,printerat e paisje elektronike qe perdoren ne fushen e medias. etj.

QELLIMI - Te mbeshtesi financiarisht aktivitetin e Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve si Donatori i vetem i ketij Fondacioni.

SELIA - Seline Shoqeria Shtypshkronja DEMOKRACIA shpk do ta ketene Rrugen Jordan Misja - Tirtane me tel.28478,fax.28446.

KAPITALI - Kapitali themeltar i shoqerise eshte afersisht 1 milion leke.

Afati i Veprimtarise se Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA do te jete i pakufizuar mbi 10 vjetë.

Administrator i Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k do te jete Ing. Fejzi Astrit BOZGO me Ortak dhe Pronar te vetem " Fondacionin AGJENSIA SHQIPTARE E BOTIMEVE."

Në menyre qe te mos kete pengesa ligjore e administrative ne ushtrimin e veprimtarise dhe aktivitetit te saj ,kerkoj nga Gjykata e Rrethit Tirane rregjistrimin e Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACIA sh.p.k. si Person Juridik prane kesaj Gjykate,bazuar kjo ne Nenin 5 te Ligjit 7512 date 10 o8.1991 dhe Ligjit 7638 te dates 19.11.1992 .

KERKUESI
Ing. Fejzi Astrit BOZGO



Fondacioni AGJENSIA SHQIPTARE E BOTIMEVE



Shtypshkronja DEMOKRACIA

Tirana -ALBANIA

Phon. 355 42 28478

Fax . 355 42 28446

VERTETIM

Bordi Drejtues i Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve ka vendosur ne nje nga mledhjet e tij te radhes qe drejtor administrativ i Shoqerise Shtypshkronja DEMOKRACI te jete Ing. FEJZI BOZGO. Leshohet ky vertetim per efekte veprimesh rregjistrimi te Shoqerise ne Gjykatën e Rretit -Tirane.

Per FONDACIONIN ASHB

KRYETARI

Arben BLLACI



Tirane Qershor 1995

11.477/1

Zj. M. Dedi
30.12.1999

ff.

KËRKESË

KËRKUESI: Arben Bllaci, i biri i Spiros dhe i Filanthit, datëlindja 22 qershor 1961, lindur e banues në Tiranë, Rruga Ali Visha, Pall. Sindikatës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k. .

OBJEKTI: Depozitim i vendimit Nr. Ekstra të datës 29. 12. 1999 të Bordit Drejtues të Fondacionit "Agjensia Shqiptare e Botimeve" si pronar i vetëm i shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k. për ndryshimin e administratorit të shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Ligji 7638 dt. 19. 11. 1992 dhe 7667 dt. 28. 01. 1993.

Gjykatës së Rrethit Tiranë

Me vendim nr. 11477 të datës 05. 07. 1995 të Gjykatës së rrethit Tiranë Sh.p.k. "**DEMOKRACIA**" është regjistruar si person juridik.

Në bazë të vendimit të Bordit Drejtues të Shtypshkronjës "A.S.H.B. "Shtypshkronja Demokracia". Nr. Ekstra dt. 29. 12. 1999, kërkoj të bëj ndryshimin e Drejtorit Administrator nga Zoti Fejzi Bozgo dhe emërimin si Administrator Zotin Arben Bllaci.

Të bëhen ndryshimet përkatëse në Zyrën e Regjistrimit Tregtar.

KËRKUESI

ARBEN BLLACI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 2891 REP

VËRTETIM

Ne Tirane sot me date 30. 12. 1999, para meje noteres Lindita Lleshi, u paraqit parsonalisht Zoti Arben Bllaci, Drejtor Ekzekutiv i Shtypshkronjës "Demokracia" Sh.p.k., identifikuar nga pasaporta nr. 0005646, i cili deklaroi se sa siper eshte një kërkesë shkruar sipas vullnetit te tij te lire e te plote, te cilen e nenshkroi para meje, nenshkrim te cilin une bazuar ne ligj e vertetoj.

Tea
depozitimi
në zyrën e regjistrimit
me vendimin
nr. 2891/REP e dt. 30.12.1999.
M. Dedi
Emelati





Nr. Prot. EKSTRA

Lenda : Dorheqjeje i parevokueshme nga detyra e drejtorit ekzekutiv te Shtypshkronjes DEMOKRACIA sh.p.k

Bordit Drejtues te Fondacionit
Agjensia Shqiptare e Botimeve -Shtypshkronja DEMOKRACIA

Te nderuar zoterinj,
Ne cilesine e Bordit Drejtues te fondacionit, ju ve ne dijeni per vullnetin tim per te paraqitur dorheqjen e parevokueshme nga detyra e drejtorit ekzekutiv te shtypshkronjes "Demokracia" shpk, per motive te forta personale e arsye shendetsore.

Gjithashtu, ne pritje te personit i cili do te ngarkohet nga bordi per te kryer kete detyre ,ne kushtet kur puna e perpjekjet duhet te vazhdojne per te mos penguar daljen e shtypit, si dhe mbeshtetur ne Statutin e Fondacionit dhe ne rregullat organizative qe permban ky statut, mbas dates 15 dhjetor e tutje, do te vazhoj te jap kontributin tim ne zgjidhjen e problemeve teknike e te gadishmerise prodhuese te shtypshkronjes me detyrimin moral si antar i bordit drejtues te ketij Fondacioni.

Ju dorezoj kete doreheqje te parevokueshme me besimin ne mirkuptimin dhe vleresimin e punes time te deritanishme.

Me respekte
Ing. Fejzi Bozgo



Tirane 15 Dhjetor 1999

V E N D I M

Nr. Ext, datë 29/12/1999

I M B L E D H J E S S E B O R D I T D R E J T U E S

Bordi drejtues i Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve - Shtypshkronja Demokracia i thirrur për të marrë vendim me kërkesën e Drejtorit të tij ekzekutiv, pasi u informua për dorëheqjen e parevokueshme të zotit Fejzi Bozgo nga funksionet e administratorit të shtypshkronjës "Demokracia" dhe për propozimin në këtë detyrë të zotit Arben Bllaci, aktualisht Kryetar i fondacionit,

V E N D O S I:

1. Pranohet dorëheqja e Administratorit të shoqërisë "Shtypshkronja Demokracia" sh.p.k., zotit Fejzi Bozgo;
2. Administrator i shoqërisë "Shtypshkronja Demokracia" bëhet zoti Arben Bllaci.
3. Ngarkohet administratori ir ri që të ndjekë procedurat ligjore për reflektimin e këtij ndryshimi në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi më datë / / .

PER BORDIN DREJTUES

KRYETARI

DREJTORI EKZEKUTIV

ARBEN BLLACI



FEJZI BOZGO










PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SE BORDIT DREJTUES

Bordi drejtues i Fondacionit Agjensia Shqiptare e Botimeve - Shtypshkronja Demokracia i thirrur për të marrë vendim me kërkesën e Drejtorit të tij ekzekutiv, pasi u informua për dorëheqjen e parevokueshme të zotit Fejzi Bozgo nga funksionet e administratorit të shtypshkronjës "Demokracia" dhe për propozimin në këtë detyrë të zotit Arben Bllaci, aktualisht Kryetar i fondacionit, hodhi në votim këtë propozim në përputhje me dispozitat përkatëse të Fondacionit. Votimi pasqyrohet i plotë në procesverbal. Anëtarët e bordit nënshkruajnë në përputhje me votën e tyre, si vijon:

Anëtari	Pro	Kundër	Abstenim
Arben Bllaci		_____	_____
Mehmet Elezi	_____	_____	_____
Bardhyl Londo		_____	_____
Astrit Patozi	_____	_____	_____
Ylli Rakipi		_____	_____
Lutfi Dervishi		_____	_____
Fejzi Bozgo		_____	_____

(VULA)



REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4387 Rep.

V E R T E T I M

Sot me daten 30.12.1999(nentedhjete e nente),para meje noteres ,u paraqiten personat e mesiperm ,me dokumentin e identifikimit , te cilet me deklaruan se sa me siper eshte neneshkrimi i tyre dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjes.

NEXHLA KELLEZI
DHOMA E NOTEREVE
TIRANE

